

MALI SHARR

park i ardhshëm nacional

Mali Sharr është një prej masiveve më të larta malore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shtrihet në pjesën veriperëndimore të vendit, në kufirin me Kosovën dhe Shqipërinë. Në pjesën e Maqedonisë shtrihet në sipërfaqe prej 841km (nga gjithsej 2480 km²), me lartësi mbidetare prej 630m deri në majën më të lartë, Turku i madh (Titov věrv) me lartësi 2748m.



Thesari ynë më i madh me biodiversitet



Република Северна Македонија
Министерство за животна средина
и просторно планирање



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Mjedisit Jetësor
dhe Planifikimit Hapësinor



Popullata vendase dhe natyra e Malit Sharr

Falë prezencës shekullore të njerëzve dhe lidhjes së tyre të pandarë me natyrën, sot Mali Sharr është shumë i pasur në aspekt të viseve me kullosa të gjera, por edhe me pyje, livadhe dhe pemishte të vogla. Kullosat e sotme të Malit Sharr janë formuar me ndihmën e praktikave tradicionale shekullore të biegtorisë. Biegtoria me intensitet të ulët kontribuon për mbijetesën e bashkësive të pasura bimore të kullosave natyrore dhe mbarëvajtjen e biodiversitetit të tyre. Në Malin Sharr gjenden disa prej fshatrave të fundit të vendosura në lartësi mbidetare prej 1000 metra ku popullata merret me bujqësi dhe biegtori. Të tillë janë fshatrat: Vejçë, Veshallë, Bozovcë etj. Përveç kësaj, popullata vendase i ka të njohura mirë edhe frytet pyjore dhe bimët shëruese, të cilat shpesh mblihen për shitje dhe përdorim personal.

HABITATET DHE EKOSISTEMET

Prania e njeriut nëpër shekuj dhe praktikat tradicionale kanë kontribuar që në Malin Sharr të dallohen një numër i madh i habitateve. Pasuria floristike, madhësia e masivit, lartësia relative dhe absolute mbidetare, diversiteti në formacionet gjeologjike, zhvillimi gjeologjiko-historik bëjnë që mali të karakterizohet me një diversitet të lartë ekosistemesh, ekosisteme ujore, pyjore, barishtore të lagështa, shkëmbore etj. Sipas klasifikimit të Direktivës së Bashkimit Evropian për Habitata, deri tani janë identifikuar gjithsej 14 lloje habitatesh në Malin Sharr.

UJËRAT

Mali Sharr është i treti me radhë në Ballkan sipas numrit të liqeneve glaciale – gjithsej 30, nga të cilat 21 janë të përhershme. Liqeni më i madh është i Bogovinjës me thellësi prej 4-5m. Nga pjesët më të larta të Malit Sharr lëshohen numër i madh ujëvarash drejt fundit të Pollogut, nga të cilat më të mrekullueshme janë ato të Lumit Vratniçka. Lumi Shkumbin është dega më e madhe e lumit Vardar, në rajonin e të cilit bëjnë pjesë pothuajse të gjitha lumenjtë e këtij mali. Në Malin Sharr ka afër njëqind burime, nga të cilat burimi në rrjedhën e Liqenit të Madh gjendet në lartësinë më të lartë mbidetare prej 2460m.

PYJET

Më të përfaqësuara janë pyjet e ahut, bredhit norvegjez dhe bredhit të bardhë. Në Sharr ka edhe sipërfaqe të vogla me pyje moike. Lokalitetet më të rëndësishme me pyje të bredhit norvegjez në Maqedoninë e Veriut janë Ceripashina, Pllati dhe Leshnica e Poshtme. Krahas tyre, të rëndësishme janë edhe pyjet e bredhit të bardhë, bredhit norvegjez-të bardhë, bredhit të bardhë-ahut dhe pyjet moike me mbetje të bashkësive të rrobullit. Në Malin Sharr hasim edhe lloje tjera të rëndësishme, siç janë: gështenja e butë, panja e malit, panja e Ballkanit, shtogu i kuq, etj.

KULLOSAT

Karakteristikë e Malit Sharr janë sipërfaqet e mëdha me kullosa malore dhe alpine. Veçanërisht pjesa jugore e malit (Moravë, Lerë, Fudan, Niçpur dhe Mali i Bogdës) është i mbuluar tërësisht me vegetacion kullosore subalpine. Për shkak të florës së pasur, nga ky rajon dalin edhe produktet më cilësore të qumështit.

VISET

Visi më i rëndësishëm dhe shumë i vlerësuar i Malit Sharr është visi i pyjeve të bredhit norvegjez-bredhit të bardh, pastaj viset e larta malore shkëmbore dhe gurore (veçanërisht viset shkëmbore gëlqerorë), visi i kullosave të larta malore gëlqerore, visi rural i Malit Sharr, visi i pyjeve mezofile gjethegjërë dhe visi i kullosave të larta malore të silikatit.

FLORA

Në Malin Sharr janë regjistruar 1260 lloje të bimëve vaskulare prej të cilave 32 janë endemike dhe 269 lloje janë myshqe. Janë zbuluar gjithsej 662 alga silikate – diatome, nga të cilat 18 janë endemike, ndërsa 94 të reja për shkencën. Prezenca e këtyre llojeve është e lidhur me ujërat të pastra dhe shkallë të ulët të ndotjes.

KËRPUDHAT DHE LIKENET

Momentalisht, në Malin Sharr njihen 517 lloje kërpudhash dhe 160 lloje likenesh. Afër 80 lloje të kërpudhave mund të shfrytëzohen për ushqim të njerëzve, ndërsa 33 konsiderohen si të rëndësishme për biodiversitetin.

GJITARË

Gjithsej 58% të faunës së përgjithshme të gjitarëve në Maqedoninë e Veriut hasen edhe në Malin Sharr. Në aspekt të mbrojtjes, të rëndësishme janë edhe llojet endemike: mi fushe, mi i shkëmbit, urithi i stankoviqit, por edhe gjitarët e mëdhenj si ariu i murmë, rrëqebulli i Ballkanit dhe dhia e egër. Shpallja e Malit Sharr park nacional do të ketë ndikim të rëndësishëm edhe në ruajtjen e specieve të rrezikuara të rrëqebullit të Ballkanit, i cili haset në pjesët jugore të Malit Sharr.

ZOGJ

Në Malin Sharr janë identifikuar 128 lloje zogjsh. Në të kaluarën, në Malin Sharr kanë qenë të pranishëm sot – shkaba mjekroshe dhe e zezë, si dhe gjeli bishtliër. Nga shkabat vërehet kali i qyqes, i cili është i rrezikuar sipas Listës së kuqe të IUCN-së dhe shkaba kokëbardhë, banorë të malit.

MERIMANGAT DHE INSEKTET

Dy lloje merimangash nga gjithsej 266 të regjistruara në Malin Sharr janë endemike. Sipas hulumtimeve të fundit, numri i përgjithshëm i insekteve të regjistruara në Malin Sharr është 1847. Numri i madh i llojeve endemike janë vërejtur te radhët pranverorja, kandra drejtflatëror, tartabiqe, kraharabartët, kadizët, kandrat me dy krahë dhe krahëfortët. Për nga numri, endemizëm më të madh të këtyre llojeve është vërejtur te krahëfortët me gjithsej 69 lloje. Mali Sharr është veçanërisht mal i pasur me flutura. Janë regjistruar gjithsej 963 lloje, nga të cilat një është endemit ballkanik. Nga fluturat e ditës të pranishme janë 176 taksonë, përkatësisht 86% të të gjitha fluturave të ditës të regjistruara në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

AMFIBET DHE ZVARRANIKËT

Nga gjithsej 15 lloje të amfibeve në Maqedoninë e Veriut, 11 hasen në Malin Sharr; ndërsa nga zvarranikët, të përfaqësuara janë 17 lloje, gjë që është gjysma e numrit në të gjithë shtetin.

PESHQIT

Peshqit e Malit Sharr janë studiuar dobët, por dihet se popullata e troftës së Maqedonisë është nën presion të fortë të njeriut, sepse është nënshtruar peshkimit sportiv me metoda jolegale të peshkimit dhe ndërtimit të një numri të madh të hidroelektraneve të vogla. Trofta e Maqedonisë është edhe lloj endemik i Ballkanit.

RACAT AUTOKTONE

Karakteristika të rëndësishme të Malit Sharr janë raca vendase e qenit – qeni i Sharrit, si dhe dhentë e Sharrit.

Turizmi në Malin Sharr

Karakteristikat gjeografike të Malit Sharr, vlerat natyrore, si dhe trashëgimia e pasur kulturore dhe historike janë bazë e shkëlqyeshme e zhvillimit të turizmit rural, sporteve të ndryshme dhe aktiviteteve rekreative. Komunitet në Rajonin e Pollogut shohin potencial jashtëzakonisht të madh në zhvillimin e turizmit dimëror për bërje ski në territorin e tyre, veçanërisht komunat e Tetovës dhe Bogovinjës. Në territorin e Tetovës gjendet qendra më e njohur rekreative dimërore në vend, Kodra e Diellit, e vendosur në afërsi të majës së njëjtë malore (1780m). Në kuadër të turizmit aventuresk janë zhvilluar ecja malore dhe parashutizmi, kalërimi, alpinizmi, ndërsa në kushte dimërore lëvizja me shkopinj për ski, ngjitja nëpër akull etj. Në aspekt të turizmit rural, zhvillimi i rëndësishëm në 10 vitet e fundit është vërejtur në fshatrat Jellovcë (e poshtme dhe e epërme), Pozharenë, Urviç, Jellovanë, Lisec, Bozovcë, Varvarë, Leshok, Belovishtë dhe Vratniçë. Kultiivohen produkte organike dhe praktikohet ruajtja tradicionale e bagëtisë. Në parkun e ardhshëm nacional theks të veçantë dhe mbështetje në aspekt të zhvillimit të turizmit rural duhet të kenë fshatrat si Bozovcë, Veshallë, Vejçë, Breznë, Jeloshnik, Belovishtë, Vratniçë, Setollë dhe Përvece si vende të cilat gjenden në kufijtë e zonës së mbrojtur.

Mali Sharr si park i ardhshëm nacional

Iniciativa që Mali Sharr të bëhet park nacional është e vjetër me dekada. Vitet e fundit kjo iniciativë përjeton një progres institucional me përgatitje të Studimit për vlerësimin e Malit Sharr (2020) dhe me pranimin e Vendimit për pranueshmërinë e propozimit për shpallje të një pjese të Malit Sharr zonë e mbrojtur në kategorinë II – park nacional nga ana e Qeverisë (05.05.2020), në pajtim me Ligjin për mbrojtje të natyrës. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është në proces të përgatitjes së propozim-ligjit për Malin Sharr, i cili në pajtim me rregullativën ligjore do të jetë i arritshëm për publikun dhe për komentim nga ana e publikut të prekur deri në përfundimin e procedurës me miratim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shpallje të Malit Sharr park nacional*.

*Në pajtim me nenin 72 të Ligjit për mbrojtje të natyrës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/04 me ndryshime dhe plotësime), parku nacional është një zonë e gjerë kryesisht e pandryshuar në tokë ose në ujë me vlera të shumta natyrore, që përfshin një ose më shumë ekosisteme të ruajtura ose të ndryshuara pak, ndërsa fillimisht është dedikuar për ruajtjen e pasurisë burimore natyrore, kulturore dhe shpirtërore. Parku nacional ka dedikim shkencor-hulumtues, kulturor, edukativ-arsimor dhe turistik-rekreativ.

Ndarja administrative dhe kufijtë e parkut

Territori i parkut të ardhshëm nacional, në aspektin administrativ u përket shtatë komunave: Komuna e Jegunovcës, komuna e Tearcës, komuna e Tetovës, komuna e Bogovinjes, komuna e Vrapçishtes, komuna e Gostivarit dhe komuna e Mavrovës dhe Rostushës. Pjesa më e madhe e sipërfaqes i përket komunës së Tetovës (220,3 km²), ndërsa pjesa më e vogël (26,4 km²) komunës së Mavrovës dhe Rostushës. Sipas propozimit, në kufijtë e parkut të ardhshëm nacional Mali Sharr do të hyjnë 8 fshatra, ndërsa vendosja e zonës së mbrojtur do të ndikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi mbi 94 fshatra dhe dy qytete në Rajonin e Pollogut. Në zonën për menaxhim aktiv dhe zonën strikte të mbrojtjes, nuk ka vendbanime, ndërsa në zonën për shfrytëzim të qëndrueshëm gjenden fshatrat në vijim: Bozovcë, Brodec, Vejcë, Veshallë, Setollë, Jedoarcë, Jellovcë e Epërme dhe Përvcë.

Natyra e Malit Sharr meriton të ruhet

Për shkak të vlerave të jashtëzakonshme natyrore, pjesë të Malit Sharr identifikohen si një prej zonave më të rëndësishme për ruajtje të natyrës në nivel nacional, rajonal dhe evropian. Mali Sharr në nivel nacional identifikohet si lokalitet i rëndësishëm ornitologjik, zonë e rëndësishme bimore dhe zonë e rëndësishme për flutura. Një pjesë e Malit Sharr është përfshirë në Rrjetin e Smeraldit, që del nga obligimet e shtetit për implementim të Konventës për mbrojtje të botës së egër dhe habitateve natyrore në Evropë (Konventa e Bernës). Mali Sharr paraqet zonë potenciale të ardhëshme Naturë 2000, me vlera të larta natyrore, por për vërtetimin e tyre nevojitet të realizohen hulumtime shkencore shumëvjeçare për prezencë të habitateve dhe llojeve me rëndësi për BE-në, në pajtim me direktivat për habitate dhe zogji të BE-së. Përveç biodiversitetit të pasur, ky mal është veçanërisht i rëndësishëm për nga viset unike që janë formuar me shekuj dhe si rezultat i blegtorisë tradicionale edhe në aspekt të agrobiodiversitetit, racave vendase dhe kullosave jashtëzakonisht të pasura.

Kjo broshurë është përpunuar në kuadër të fushatës publike për shpallje të Malit Sharr park nacional të mbështetur nga projekti i financuar nga Fondi global për mjedisin jetësor "Arritja e mbrojtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efikas me zonat e mbrojtura dhe integrimi i biodiversitetit në planifikimin e shfrytëzimit të tokës" (STAR5), i cili implementohet përmes Programit për mjedisin jetësor të Kombeve të Bashkuara (UNEP), ndërsa Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është partner kryesor dhe shfrytëzues. Fushatën publike për shpallje të Malit Sharr park nacional e realizon me mbështetje të Qendrës për edukim dhe zhvillim – CED, Tearcë si partner lokal, në bashkëpunim me Shoqatën Ekologjike të Maqedonisë dhe platformën "Miq të e Sharrit" dhe organizatat joqeveritare partnere nënshkruese të Memorandumit për bashkëpunim.